



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 2 nëntor 2015
Nr. ref.: RK 851/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI79/15

Parashtrues

Loresa Fetahu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 83/2015, të 30 prillit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Lorea Fetahu, nga Lupçi i Poshtëm, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Pml. nr. 83/2015), të 30 prillit 2015, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtrueses për mbrojtje të ligjshmërisë. Aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili, pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht neni 24, paragrafi 1 dhe 2 [Barazia para Ligjit].
4. Parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht, të parandalojë ekzekutimin e dënimit ndaj saj, e cila, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. nr. 247/14, të 1 tetorit 2014, ishte dënuar me burgim prej 1 (një) viti.
5. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata të mos e zbulojë identitetin e saj.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 qershor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 29 qershor 2015, Kryetarja caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 10 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës, në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 1 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi PKR. nr. 247/14), shpalli parashtruesen e kërkesës dhe A.C. fajtores për veprën penale të grabitjes,

në pajtim me nenin 329, paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së dhe u dënuan me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

12. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjyimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar që: *“... gjykata nuk ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës”*.
13. Më 26 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 18/2015) e refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar që:

“[...] duke shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me të akuzuarën Lorea Fetahu, kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet e mbrojtjes për një dënim më të butë nuk janë të bazuara. Në fakt, qëndrojnë rrethanat lehtësuese në të cilat thirret mbrojtësja e të akuzuarës, por nuk janë të asaj natyre që justifikojnë një dënim më të butë me burg sesa ai i shqiptuar nga shkalla e parë. Pra, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës Lorea Fetahu nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është adekuat me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe me të do të mund të ndikohet në parandalimin e saj nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe në rehabilitimin e saj, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së”.

14. Me të njëjtin vendim, Gjykata e Apelit e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në lidhje me A. C. duke konstatuar se:

“Gjykata e Apelit vlerëson se ankesa e mbrojtëses së të akuzuarës A.C. për një dënim më të butë është e bazuar për këtë arsye: e akuzuara është e moshës së re, e gjendjes së dobët ekonomike, ka pasur sjellje korrekte gjatë zhvillimit të procedurës penale, e ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendim të thellë për veprën e kryer, gjë që e theksoj edhe në seancën e Kolegjit të kësaj gjykate. Duke pasur parasysh këto rrethana veçanërisht faktin se e akuzuara është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore në lëndën penale për të cilën çështje janë duke u zhvilluar hetimet dhe gjendjen e saj jo të mirë shëndetësore, gjë që vërtetohet nga dokumentet mjekësore por është vërejtur edhe në seancën e Kolegjit – pengesa në të folur, shikim dhe shtangim të fytyrës, kjo Gjykatë vlerëson se edhe me kërcënimin për dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj, të akuzuarës dënimin e shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej një viti ia kushtëzoj me bindje se ky dënim është adekuat me peshën dhe rrezikshmërisë shoqërore dhe do të ndikohet tek e njëjta në të ardhmen që të mos kryejë vepër penale”.

15. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, duke pretenduar: *“shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal në dëmin e të gjykuarës. Pasi që janë shkelur dispozitat e përmendura më sipër në këtë kërkesë janë shkelur kundër saj, fakte të cilat kanë ndikuar që Kodi Penal të zbatohet gabimisht ndaj saj”*.

16. Më 30 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 83/2015) refuzoi kërkesën e parashtrueses për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke konstatuar se *“aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta dhe dispozitivi i aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë përmban të gjitha elementet të cilat përbëjnë figurën e veprës penale, për të cilën e dënuara është shpallur fajtore”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtat që kanë të bëjnë me *“barazi para ligjit”*.
18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *“[...] Gjykata Supreme duke refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndërsa ka aprovuar ankesën e personit tjetër të akuzuar (bashkë-kryerësja A. C.) dhe ka ndryshuar dënimin me burg në dënim me kusht, ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë”*.
19. Parashtruesja e kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata: *“që të sigurojë që të gjitha palët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe në këtë mënyrë të shqiptojë dënimin me kusht edhe për parashtruesen e kërkesës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

(d) *parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

23. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Pml. nr. 83/2015), duke pretenduar se është shkelur e drejta e saj për barazi para ligjit.
24. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i është përgjigjur këtij pretendimi, duke konstatuar që: *“nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarës nga ana e gjykatës së shkallës së dytë gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, sa i përket të dënuarës A.C., në dëm të të dënuarës Loresa Fetahu, meqenëse përgjegjësia është individuale, andaj edhe dënimet janë individuale dhe rrethanat qofshin ato rënduese apo lehtësuese vlerësohen individualisht për secilin të dënuar, ashtu siç ka vepruar në këtë rast edhe gjykata e shkallës së dytë kur ka vendosur lidhur me pretendimet ankimore për të dënuarat...“.*
25. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat ishte refuzuar kërkesa e saj për mbrojtje të ligjshmërisë, përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të saj individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur dëshmi për të arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.
26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të Ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
27. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve të tjera publike, kur kjo është e mundur, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI70/11, *parashtrues të kërkesës: Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e saj, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.
29. Prandaj, Gjykata konkludon se, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

30. Siç u theksua më lart, parashtruesja gjithashtu kërkon nga Gjykata që të merr “vendim me të cilin do të caktohet masa e sigurisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR. nr. 247/14, për mosekzekutim të dënimit [...]”.
31. Siç është përmendur më lart, parashtruesja nuk ka treguar rast *prima facie* mbi pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, në bazë të rregullit 55 të Rregullores së punës, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa për moszbulimin e identitetit

32. Sa i përket kërkesës së parashtrueses për të mos zbuluar identitetin e saj, Gjykata e refuzon kërkesën e saj si të pabazuar, sepse nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës dhe informatë lidhur me arsyet që parashtrueses së kërkesës të mos i zbulohet identiteti i saj. Përveç kësaj, Gjykata vëren se identiteti i parashtrueses së kërkesës tashmë është zbuluar në procedurat e gjykatave të rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 27 dhe 47 të Ligjit, rregullit 36 (2) (b) dhe (d), 55 (4) dhe (5), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. TA REFUZOJË kërkesën e parashtrueses për moszbulim të identitetit;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi